

**INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR
KREDI ME KUFİ (OVERDRAFT) SIGURUAR ME LETRA ME VLERË**

Prezantim	Ky informacion përbën një prezantim të ofertës që Banka do të bejë sipas kushteve aktuale të tregut. Ky informacion nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Dhënia e informacionit sipas këtij dokumenti nuk parasheh detyrimin e Bankës për të akorduar kredi.
1. Banka	“Banka e Pare e Investimeve”, ALBANIA Sh.a Adresa: Bulevardi “Deshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla 2, kati 14, Tiranë. Adresa e Web-it: www.fibank.al Telefona pa pagese 08000111: Tel 042276702/3; Fax: 042280210
2. Emri i Produktit	Kredi me Kufi (Overdraft) e siguruar me Letra me Vlerë
3. Qëllimi i produktit	Qëllimi i kredisë me kufi (Overdraftit) është për të plotësuar nevojat afatshkurtra për likuiditet të klientëve të cilët kanë mundësinë e ofrimit të një garancie në letra me vlerë (Bono Thesari, Obligacione)
4. Përshkrimi i produktit	Banka i jep mundësi klientit për të tërhequr apo për të urdhëruar transfertat deri në një limit të caktuar, duke e kaluar gjendjen efektive të mjeteve në llogarinë rrjedhëse. Vlera e tregut për bonot e thesarit dhe Letrat me vlerë duhet të mbulojë 133% e shumës së kredisë. E vlefshme për individë që zoterojnë një Bono Thesari apo Obligacion të lëshuar nga Qeveria shqiptare, të regjistruar në Fibank
5. Norma e Interesit	Normat e interesave të overdraftit të siguruar me letra me vlerë: <i>EUR: Euribor 12M + 1%, jo më pak se 3.99%</i> <i>Leke: T-bills 12M + 1%, jo më pak se 3.99%</i> Interesi llogaritet çdo ditë dhe do të paguhet çdo fund muaji mbi balancën debitore të llogarisë rrjedhëse të kredisë me kufi (overdraft), duke filluar nga dita e parë e përdorimit të kredisë me kufi (overdraft) në bazë të shumës së përdorur. Interesat përkatëse dhe shumat e tjera të detyrueshme për Huamarrësin do të llogariten në bazë të ditëve efektive, duke pranuar vitin me 360 ditë. $\text{Interesi} = \text{Limit i përdorur} * N.\text{interesit} * \text{Ditët e përdorura} / 360 \text{ ditë}$
6. Norma efektive e interesit (NEI)	Është totali i kostos së kredisë me kufi (overdraft) për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e limitit të kredisë me kufi (overdraft) të dhënë dhe e llogaritur në përputhje me kërkesat e rregullores së bankës së Shqipërisë “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare financiare”, e bazuar në supozimin që kontrata e kredisë që do të firmoset është e vlefshme për afatin kontraktor dhe palët përmbushin rregullisht detyrimet sipas kushteve dhe mënyrës së rënë dakord në kontratë.
7. Afati maksimal, shuma dhe monedha e kredisë	Shuma maksimale 10 000 000 Lekë dhe ekuivalenti i saj në EUR. Monedha e ofruar : Lekë, EUR Afati maksimal deri në 12 muaj. Kredia me kufi (overdraft) duhet të shlyhet brenda 60 ditëve të fundit të afatit të kredisë me kufi (overdraft). Është i rinovueshem pas një viti sipas dëshirës së klientit.
8. Vlera e kredisë	

9. Kohezgjatja e kontrates se kredise	muaj
10. Plani i amortizimit	Interesi paguhet çdo fund muaji i llogaritur për shumën dhe ditët e përdorura. Principali mund të paguhet në çdo moment i plotë ose i pjesshëm sipas dëshires së klientit. Principali = Limiti i përdorur NEI = _____% <i>Pëllogaritja e NEI-t është pjesë integrale bashkangjitur këtij dokumenti.</i>
11. Tërheqja e fondeve	Limiti i Overdraftit do ti akordohet Klientit në llogarinë rrjedhëse dhe përdorimi i tij do të krijojë një tepricë debitore në këtë llogari. Tërheqja e kredisë do të bëhet në një nga mënyrat : 1.Me ane të tërheqjes në të holla 2.Me ane të urdher pageses së dhënë me shkrim në favor të të tretëve 3.Me ane të mjeteve elektronike Kur banka konstaton së Kredimarresi ka dalë jashtë kushteve të parashikuara në Kontratën e kredisë nënshkruar nga palet, Banka ka të drejtë të kërkojë kthimin e menjehershëm të shumës së kredisë dhe të gjithë detyrimeve të lidhura me të përmes një njoftimi me shkrim nga ana e bankës.
12. Kosto shtesë e detyrueshme për përfitimin e kredisë	Komision menaxhimi: 1% mbi shumën e miratuar të kredisë me kufi (overdraft) në ditën e disbursimit të kredisë me kufi (overdraft) dhe 0% nëse punonjës i FIBANK Komision për bllokimin e letres me vlerë: 1'000 Leke Komision për zhblokimin e letres me vlerë: 1'000 Leke
13. Shlyerje para afatit të maturimit	Klienti ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, para afatit të maturimit, shlyerjen e pjesshme ose të plotë të kredisë pa asnjë komision
14. Kosto shtesë të tjera	• Kosto e mbajtjes së llogarisë: Për celjen e llogarisë së rrjedhëse në të cilën do të lëvrohet kredia dhe do të përdoret për kryerjen e pagesave të kredisë, Banka do të aplikojë komision në masën prej 100 lekë në muaj /1 EUR në muaj për monedhën EUR / ekuivalenti i 1 EUR për llogaritë në monedhën USD në muaj • Kosto noterizimi në varësi të numrit të kontratave që noterizohen dhe sipas tarifave të notereve
15. Shuma totale që klienti ka për të paguar	Shuma e totalit të kredisë = (Vlera e Kryegjese + Vlera e Interesit + Vlera e Komisionit të manaxhimit të kredisë + Vlera e mbajtjes së komisionit të llogarisë + Vlera e bllokimit të vlerës me vlerë + Vlera e zhblokimit të vlerës me vlerë + Shpenzime noteriale) *Për shumat e kredive deri në ALL 1 mio nuk aplikohen shpenzime noteriale

16. Vlera e kështit të kredisë, e shprehur në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, mund të ndryshojë.	Ju do të merrni një njoftim në rastet kur, si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, si psh - kështi i kredisë [50.000 lek] tejkalon vlerën [60.000 lek] nese te ardhurat jane ne lek kredia ne euro - kështi i kredisë [400 euro] tejkalon vlerën [480 euro] nese te ardhurat jane ne euro kredia ne lek Ju do të keni mundësinë të konvertoni kredinë në monedhen ne te cilen keni te ardhurat nëse si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, kështi i kredisë rritet me shume se 20% sesa kundërvlera e kështit që do të rezultonte nëse do të aplikohet kursi i këmbimit midis monedhës së kredisë dhe monedhës në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, në datën e nënshkrimit të kontratës. Konvertimi mund të kryhet bazuar në rezultatet e analizës apo të vlerësimit më të fundit të bankës, mbi monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat
17. Njoftimi zyrtar midis paleve	Banka informon klientin një herë në vit për gjendjen e llogarisë, duke përcaktuar informacionin në lidhje me periudhën kalendarike të cilës i referohet gjendja e llogarisë. Të gjithë njoftimet komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim të dorëzuara personalisht ose me postë në adresën e depozituar pranë bankës ose kur është e mundur me një mjet të qëndrueshëm komunikimi (SMS, email, disket, CD ROM, DVD, kuti postare etj). Kredimarrësi është i detyruar që për çdo ndryshim në adresat e tij të njoftojë Banken brenda 15 diteve kalendarike për këto ndryshime. Për sa kohë që ai nuk ka njoftuar adresën e re, kredimarrësi nuk ka të drejtë të kundërshtojë njoftimet e bëra në adresën e mëparshme
18. E drejta e tërheqjes nga kontrata e kredise	Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga Kontratë e Kredisë me kufi (overdraft) brenda një periudhë kalendarike 14 ditore. Ky afat fillon nga dita e nënshkrimit të kontratës së kredisë me kufi (overdraft). Përpara ushtrimit të kësaj të drejte Kredimarrësi duhet të njoftojë Bankën brenda periudhës së sipërpërmendur. Në rast se në këtë moment Banka ka disbursuar shumën e kredisë me kufi (overdraft), kredimarrësi është i detyruar të kthejë shumën e kredisë me kufi (overdraft), interesat për ditët përkatëse si dhe shpenzimet e kryera nga Banka ne funksion të disbursimit të kredisë me kufi (overdraft).
19. Mundësia e zëvendësimit të kolateralit	Klienti ka te drejte te kerkoje zevendesimin e kolateralit nese ploteson kushtet e meposhtme: - Nese zevendesimi eshte me nje leter tjeter me vlere, mbulimi te jete prej minimalisht 133% e balances se kredise/kredive qe kerkohet te mbulohet ne momentin e kerkeses - Nese zevendesimi eshte me cash colateral, mbulimi te jete prej minimalisht 105% ose 112% te balances se kredise/kredive qe kerkohet te mbulohet ne momentin e kerkeses * Vendimmarrja ne zevendesimin e kolateralit eshte subjekt aprovimi sipas rregullores te brendshme te bankes

20. Ankimi	- Ankese me shkrim pranë cdo dege - Nëpërmjet telefonit: Telefono pa pagese 08000111 Tel 042276702/3 Fax: 042280210
21. Penalitete të tjera	Në rast se kredimarrësi e kalon limitin e miratuar nga banka, ai do të paguajë interesin prej 36% i llogaritur mbi shumën me të cilën kalohet limiti i miratuar dhe kohën që është kaluar limiti. Nëse nuk janë siguruar mjetet financiare të nevojshme në ditën e përfundimit të afatit të paradhënies së akorduar, kredia me kufi (overdraft) konsiderohet si i palejuar. Pagesat e detyrueshme të pushlyera në afat për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve në llogarinë rrjedhëse të kredimarrësit në bankë, kalojnë në pagesë me kamatëvonesë me përqindje interesi në masën prej 36% mbi balancën debitore të llogarisë së kredimarrësit. Banka aplikon mbi shumën e tërë limitit të përdorur (principalit të pamaturuar) normën prej 1% përgjatë gjithë kohës që kredimarrësi do të jetë në shkelje dhe/ose mospërbushje të një prej detyrimeve që rrjedhin nga kontrata që do të firmoset mes palëve
22. Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor	Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor është 7 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij informacioni nga klienti
23. Informimi në rast refuzimi të kredisë	Banka informon konsumatorin, menjëherë dhe pa komisione, nëse një aplikim për kredi është refuzuar
24. E drejta e paisjes me kopjen e projektkontratës së kredisë	Konsumatori ka të drejtën për t'u pajisur, me kërkesën e tij dhe pa pagesë, me një kopje të projektkontratës së kredisë. Kjo e drejtë nuk do të zbatohet nëse banka, në kohën e kërkesës, nuk është e gatshme të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës së kredisë me konsumatorin.

ANEKSI ME POSHTE ESHTË I VLEFSHEM VETEM PER ATA KLIENTE QE APLIKOJNE PËR KREDI NË MONEDHË TË NDRYSHME NGA AJO NË TË CILËN GJENEROJNE TË ARDHURAT

SHEMBULL ILUSTRUES PËR RREZIKUN E KURSIT TË KËMBIMIT PËR KREDINË NË MONEDHË TË NDRYSHME NGA AJO E GJENERIMIT TË TË ARDHURAVE

Tekst sqarues për konsumatorin

Kredidhënia në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjenerohen të ardhurat, për konsumatorin që nuk është i mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, shoqërohet me rreziqe të konsiderueshme. Për shembull, një nënçmim i fortë i kursit të këmbimit, do të shkaktoje vështirësi në aftësinë e konsumatorit për të shlyer kredinë. Këto vështirësi mund të çonin në dështimin e konsumatorit për të shlyer kredinë, në kthimin e kredisë në statusin “me probleme”, dhe mund të përfundonin në fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrimit nga ana e bankës.

Ky aneks përmban një shembull me natyrë ilustruese dhe informuese, dhe nuk përfaqëson një pritshmëri apo angazhim ligjor nga kredidhënësi apo kredimarrësi.

Konsumatori që aplikon për kredi në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjeneron të ardhurat, nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti vërteton se:

- 1) e ka marrë këtë dokument nga banka përpara lidhjes së kontratës së kredisë;
- 2) e ka kuptuar shembullin dhe efektet e mundshme nga lëvizjet në kursin e këmbimit;
- 3) është i bindur që mund të përballojë rreziqet që shoqërojnë kredinë.

Dokumenti i nënshkruar është pjesë e analizës që bën banka për dhënien e kredisë tek konsumatori, por dokumenti i nënshkruar nuk e detyron bankën për dhënien e kredisë dhe as nuk e redukton përgjegjësinë që ka banka për të kryer analizën e saj të plotë për qëndrueshmërinë financiare të aplikuesit për kredi.

Të dhëna për kredinë në monedhë të ndryshme nga monedha e gjenerimit të të ardhurave

Kredimarrësi:
 Kredidhënësi: FiBank ALBANIA
 Lloji i kredisë: Kredi Konsumatore "Security"
 Kohëzgjatja e kredisë:
 Vlera e kredisë:
 Njësia monetare: ...lek.....
 Kursi i këmbimit, në datën e vlerësimit të planit ilustrues:
 Kundërvlera e kredisë në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat:
 Norma efektive e interesit:
 Indeksi orientues/norma referencë: ..Nuk ka.....
 Marzhi: ..Nuk ka
 Norma e interesit (fikse)
 Të ardhurat mujore (bruto/neto) të huamarrësit në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat (mesatare e 3 viteve të fundit):

Tabelë 1: Kësti i kredisë dhe raporti i vlerës së kështit të kredisë ndaj të ardhurave (në %), sipas skenarëve të rrezikut të ndryshimit të kursit të këmbimit. - **Bashkengjitur**

Shembull i kështit të kredisë dhe raporti i vlerës së kështit të kredisë ndaj të ardhurave (%), sipas skenarëve të rrezikut të ndryshimit të kursit të këmbimit. Rasti kur kredia jepet në Lek dhe të ardhurat janë në EUR				
Skenari	Vlera e kështit e shprehur në monedhën e kredisë (lek) Kesti: 39,000	Kundërvlera e kështit në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat	Të ardhurat (mesatare mujore të 3 viteve të fundit) në monedhën në të cilën ato gjenerohen	Raporti i vlerës së kështit ndaj të ardhurave
	(a)	(b)	(c)	(d) = (b)/(c)
Kursi i këmbimit nuk ndryshon (kursi Eur/Lek në datën e marrjes së informacionit për kredi)	130	300	800	37.5%
Nënçmim i kursit të këmbimit me 5% (i supozuar në të ardhmen)	124	315	800	39.3%
Nënçmim i kursit të këmbimit me 20% (i supozuar në të ardhmen)	104	375	800	46.8%

Konsumatori
 (Konfirmon marrjen e këtij shembulli ilustrues)

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Datë/muaj/vit:
____/____/____